

UDHËZIM
Nr. 11, datë 14.5.2012

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

1. Në paragrafin e dytë të pikës 8.7 “Operacionet hidrokarbure”, pas fjalëve “... të importuara sipas nenit 26/1 të këtij ligji” shtohet ky paragraf:

“Në rastin e importimit të mallrave dhe shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione, për të përfituar përjashtimin nga TVSH-ja në import, subjektet duhet të paraqesin pranë organit doganor një vërtetim nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për kontraktorët dhe nënkontraktorët, së bashku me listën e mallrave të importuara.

Brenda datës 5 të çdo muaji, administrata doganore i përcjell administratës tatimore listën e detajuar të mallrave të importuara nga kontraktorët dhe nënkontraktorët.

Në rastin e importimit të nënprodukteve të naftës, për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse, përjashtimi nga TVSH-ja jepet për produktet dhe sasi të përcaktuara në autorizimet e përjashtimit të akcizës të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, udhëzimi nr. 3, datë 4.5.2012 “Për përcaktimin dhe dokumentimin e sasive të nënprodukteve të naftës, të importuara për nevojat e veta, nga shoqëritë e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode